



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
SP-079
Prishtinë, më 28 tetor dhe 17 nëntor 2016

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 28 TETOR DHE 17 NËNTOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti.

Kryetari procedoi rendin e ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2016.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Selvije Halimi, Doruntinë Maloku, Visar Ymeri, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami, Elmi Reçica, Shpejtim Bulliqi dhe Albin Kurti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me zbatimin e rezolutës së Kuvendit të Kosovës lidhur me migrimin. Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me rezolutat e miratuara të Kuvendit që bien ndesh me ligjet pozitive të Kosovës. Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me ndërprerjen e pensioneve të pleqërisë familjeve që e gëzojnë të drejtën në pension të familjeve të dëshmorëve.

Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Margarita Kadriu-Ukelli i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, në lidhje me paditë e dy kompanive ndërkombëtare ndaj shtetit të Kosovës në Gjykatën e Arbitrazhit në Uashington.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, në lidhje me largimin nga puna të punëtorëve me kontrata të përhershme nga kompania KEDS.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Lahi Brahimaj i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me zgjidhjen e problemit të aeroportit të Gjakovës.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Lahi Brahimaj i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, në lidhje me arrestimin e komandantit të Policisë së Kosovës të Regjionit të Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga ana e autoriteteve serbe.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Memli Krasniqi, në lidhje me shpërndarjen e subvencioneve për bujqit.

Deputetes Time Kadrija, në vend të ministrit Krasniqi, iu përgjigj ministri Abdullah Hoti.

Deputeti Rrustem Berisha i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, në lidhje me dëmtimin e buxhetit të Kosovës nga ana e operatorëve ilegalë.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Haxhi Shala i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala, në lidhje me kohën e përfundimit të punimeve në sallën e sporteve në qytezën e Shtimes.

Ministri Kujtim Shala nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Driton Çausi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me funksionimin e aeroportit të Gjakovës.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Driton Çausi i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, në lidhje me letrën e Amnesty International që ka të bëjë me ndërhyrjen e policisë në zyrat e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Ministri Skënder Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Zafir Berisha i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, në lidhje me bazën ligjore të funksionimit të disa OJQ-ve, të financuara nga shteti rus në veri të Kosovës.

Ministri Skënder Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me ndërprerjen e dukurisë që pjesëtarët e komunitetit serb të jenë pjesë edhe të institucioneve tona, edhe atyre të Serbisë njëkohësisht.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, në lidhje me lehtësitë që mund t'u bëhen për pajisjen e shqiptarëve të Luginës së Preshevës me dokumentacionin e Republikës së Kosovës.
Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Shukrije Bytyçi i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me konkursin për specializantë.
Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftija i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me ankesat dhe protestat e mjekëve për të realizuar të drejtën e specializimit.
Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftija i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me shtimin e numrit të institucioneve shëndetësore publike, të cilat lëshojnë certifikata shëndetësore.
Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me numrin e aksidenteve dhe dëmtimet e punëtorëve që punojnë në çdo degë të ekonomisë.
Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Salih Salihu i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me takimet që janë mbajtur me një kompani austriake për gjenerimin e energjisë.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtroi pyetje ministrit të Financave, Abdullah Hoti, në lidhje me zbatimin e ligjit për mbështetje financiare për Kryqin e Kuq të Kosovës.
Ministri Abdullah Hoti iu përgjigj deputetit.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë, Dhurata Hoxha, në lidhje me keqtrajtimin e mundshëm të të burgosurve në Qendrën Korrektuese të Prizrenit.
Ministrja Dhurata Hoxha nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Rrustem Berisha parashtroi pyetje për kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me rifillimin e punës së sekretarisë së Komisionit Qeveritar për verifikimin e statusit të veteranëve, invalidëve dhe dëshmorëve të luftës së UÇK-së.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 7, 8, 11 dhe 12 tetor 2016.

Para se të procedohet me pikat e tjera të rendit të ditës, kryetari i GP të PDK-së, Zenun Pajaziti, propozoi që pika e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartuese të shtyhet për seancën e radhës.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që ky shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartuese të shtyhet për seancën e radhës.

4. Propozim-deklarata e Kuvendit të Republikës së Kosovës adresuar Unionit Evropian për liberalizimin e vizave

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Punë të Jashtme e ka parashtruar Propozim-deklaratën për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë në Zonën Shengen.

Ai tha se lidhur me këtë çështje edhe grupet parlamentare të AAK-së dhe “Nismës” kanë parashtruar një tekst të Propozim-deklaratës për liberalizimin e vizave.

Kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme që ta paraqesë Propozim-deklaratën.

Elmi Reçica, kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-deklaratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës adresuar Unionit Evropian për liberalizimin e vizave.

Diskutimi i deputetit Elmi Reçica është dhënë në transkript.

Kryetari kërkoi nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare të deklarohen rreth këtij propozimi.

Lidhur me Propozim-deklaratën e parashtruar nga z. Reçica diskutuan: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, Aida Dërguti, në emër të GP të LV-së, Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së, Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma” dhe Qerim Bajrami, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare ta caktojnë nga një anëtar për harmonizimin e Propozim-deklaratës, e cila do të miratohet.

Kryetarët e grupeve parlamentare u deklaruan edhe një herë rreth propozimit të kryetarit të Kuvendit dhe mundësisë së harmonizimit të qëndrimeve për Propozim-deklaratën. Meqenëse nuk pati pajtime lidhur me harmonizimin e qëndrimeve rreth kësaj çështjeje, kryetari dha pauzë 15 minuta.

Pas pauzës, kryetari theksoi se nuk ka pajtim të grupeve parlamentare rreth harmonizimit të tekstit të Propozim-deklaratës, andaj kjo pikë, me vendim të seancës, u hoq nga rendi i ditës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike diskutuan: Naser Osmani, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së, Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV-së, Bali Muharremaj, në emër të GP të AAK-së, Valdete Bajrami, në emër të GP “Nisma” dhe Fikrim Damka, në emër të GP të “6+”, si dhe deputetët Armend Zemaj, Visar Ymeri, Naser Osmani, Faton Topalli, Ismajl Kurteshi, Daut Haradinaj, Hajdar Beqaj, Shqipe Pantina dhe ministri Abdullah Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	53,
Kundër-----	14,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike.
2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që, në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

* * *

Ndërkohë, kryetarja e GP “Nisma për Kosovën”, znj. Valdete Bajrami, propozoi që deputetja Shukrije Bytyqi të emërohet anëtare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetes Valdete Bajrami.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi propozimin e lartshënuar.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kamatëvonesat në transaksionet tregtare

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kamatëvonesat në transaksionet tregtare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL, znj. Sala Berisha-Shala e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin propozuar 9 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	67,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit Funksional, znj. Flora Brovina, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Për projektligjin diskutuan deputetët Besa Baftija, Ali Berisha, Shukrije Bytyqi, Fadil Beka, Hatim Baxhaku dhe Time Kadrijaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në këtë projektligj ishin propozuar 42 amendamente nga Komisioni Funksional.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41 dhe 42.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	63,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL, deputeti Salih Morina e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Për projektligjin diskutuan deputetët Bekim Haxhiu, Teuta Haxhiu, Ismajl Kurteshi dhe Shukrije Bytyçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në këtë projektligj ishin propozuar 15 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryetari e hodhi në votimi tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	67,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

10. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Më pas, kryetari e hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	59,
Kundër-----	9,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori:

V E N D I M

I. Anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave emërohen:

1. Arsim Berisha, kryesues,
2. Shkumbin Hyseni, anëtar,
3. Ilmi Ahmeti, anëtar dhe
4. Gëzim Qerimi, anëtar.

II. Mandati i të emëruarve në pikën I është 5 (pesë) vjet.

11. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Para se të procedohet me këtë pikë, kryetari propozoi që të procedohet përnjëherë edhe me votimin e pikave 12, 13 dhe 14.

Ai kërkoi nga GP që ta propozojnë nga një anëtar në Komision votues, i cili do të mbështetet nga nëpunësit e Administratës së Kuvendit për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Hajdar Beqaj, GP, PDK,
Murat Hoxha, GP, LDK,
Driton Çausi, GP, LV,
Rrustem Berisha, GP, AAK,
Shukrije Bytyçi, GP “Nisma” dhe
Mufera Shinik, GP “6+”.

Pastaj kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë me procedurat e votimit të fshehtë për pikat e rendit të ditës: *Zgjedhja e një anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës; Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit dhe Zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit.*

Kryetari i ftoi sipas listës deputetët e Kuvendit për t’i hedhur votat e fshehta në kutitë e votimit.

Ndërkohë seancën e kryesoi nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës e paraqiti deputeti Rrustem Berisha.

Rezultati i votimit ishte:

- Në votim kishin marrë pjesë 76 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 29 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

Shemsi Jashari - 29 vota,
Ilir Dukolli - 8 vota dhe
Naim Krasniqi - 9 vota.

Kryesuesi konstatoi se në rundin e parë nuk i fitoi votat e nevojshme asnjëri nga kandidatët e propozuar. Andaj, duhet të procedohet rundi i dytë, me 2 kandidatët që kanë marrë më shumë vota në rundin e parë, si në vijim:

1. Shemsi Jashari dhe
2. Naim Krasniqi.

Në emër të Komisionit votues, deputeti Hajdar Beqaj e paraqiti rezultatin e votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kishin marrë pjesë 76 deputetë,
- Të pavlefshme ishin 24 vota.

Arsim Rashiti - 50 vota,
Goran Arsiq - 2 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Z. Arsim Rashiti zgjidhet kryesues i Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, me mandat 3 (tre) vjeçar.

Pastaj, në emër të Komisionit votues deputeti Murtat Hoxha e paraqiti rezultatin e votimit për kandidatët e propozuar për zëvendës drejtor të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

- Në votim morën pjesë 76 deputetë.
- Të pavlefshme kanë qenë 10 vota.

Bashkim Halabaku -16 vota,
Xhelal Selmani -50 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Z. Xhelal Selmani zgjidhet zëvendës drejtor i Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, me mandat 5 (pesë) vjeçar.

Kryesuesi, në mungesë të kuorumit, e mbylli seancën e stome në orën 19:25. Ndërsa për vazhdimin e saj do të vendosë Kryesia e Kuvendit.

* * *

E enjte, më 17 nëntor 2016,

Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 28 tetor

Seancën e kryesoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

Para se të procedohet me pikat e papërfunduara nga seanca e mëparshme, kryesuesi i njoftoi deputetët me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e dy deputetëve nga radhët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, si në vijim: z. Nehat Baftiu, kandidat i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), zëvendëson ish-deputetin Fadil Demaku dhe z. Fatmir Shurdhaj, kandidat i po të njëjtit subjekt politik, zëvendëson ish-deputetin Ramiz Kelmendi.

Kryesuesi i njoftoi deputetët e rinj që para se ta fillojnë mandatin e deputetit, duhet dhënë betimin.

Pastaj ai e lexoi tekstin e betimit, ndërsa deputetët në fund e shqiptuan fjalën “betohem”, si dhe e nënshkruan tekstin e betimit.

* * *

Për fjalë u paraqit deputeti Visar Ymeri, i cili diskutoi në lidhje me rastin e vdekjes së Astrit Dehari në Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe kërkoi nga Kuvendi që të mbajë debat parlamentar lidhur me këtë rast.

Diskutimi i deputetit Ymeri është dhënë në transkript.

Gjithashtu, për rastin e vdekjes së Astrit Deharit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren diskutuan edhe deputetët Daut Haradinaj, në emër të GP të AAK-së, Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”, Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së dhe Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së. Diskutimet e deputetëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për debat parlamentar në Kuvend lidhur me vdekjen e Astrit Deharit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

Pas rezultatit të votimit elektronik, kryesuesi konstatoi se nuk ka vota të mjaftueshme për vendimmarrje.

Meqë në sallë nuk kishte kourum për të vazhduar me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, kryesuesi, pas konsultimit me përfaqësuesit e grupeve parlamentare dha pauzë deri në orën 14:00.

* * *

Pas pauzës, me propozim të kryesuesit u rizgjodh Komisioni votues në këtë përbërje: Hajdar Beqaj, Mirjeta Kalludra, Margarita Kadriu-Ukelli dhe Duda Balje.

Kryesuesi i ftoi deputetët që të votonin në rundin e dytë për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile dhe për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Komisionin e Pavarur të Medieve.

Pas përfundimit të procedurave të votimit të fshehtë, deputetja Margarita Kadriu-Ukelli e paraqiti raportin mbi rezultatet e votimit.

Rezultati i votimit të fshehtë në rundin e dytë për zgjedhjen e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile ishte si në vijim:

- Në votim kanë marrë pjesë 62 deputetë.
- Të pavlefshme kanë qenë 3 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

Shemsi Jashari kishte fituar 57 vota,
Naim Krasniqi kishte fituar 2 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimi edhe në rundin e dytë nuk i morën votat e nevojshme asnjëri prej dy kandidatëve për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Pas përfundimit të procedurave të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave, deputetja Margarita Kadriu-Ukelli, në emër të Komisionit votues, i paraqiti rezultatet e votimit për zgjedhjen e 1 (një) anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve. Rezultati i votimit ishte si në vijim:

- Në votim kishin marrë pjesë 62 deputetë,
- E pavlefshme ishte vetëm 1 një fletëvotim.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

- Fehmi Ajvazi kishte fituar 29 vota,
- Xhemajl Krasniqi kishte fituar 32 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Z. Xhemajl Krasniqi zgjidhet anëtar i Komisionit të Pavarur të Medieve me mandat 4 (katër) vjeçar.

15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari të Bordit të Ankesave të Mediave

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 (një) anëtar në Bordin e Ankesave të Medieve.

GP i PDK-së propozoi Selville Halimin, kryetare dhe Xhevahire Izmakun, anëtare;

GP i LDK-së propozoi deputetët Armend Zemaj dhe Blerim Grainca;

GP i AAK-së propozoi deputetin Lahi Brahimaj për anëtar;

GP "Nisma" propozoi deputetin Zafir Berisha për anëtar;

GP "6+" e propozoi deputeten Duda Balje për anëtare;

Ndërsa deputetët e GP të LV-së dhe GP të LS-së nuk ishin të pranishëm në seancë për të propozuar anëtarët e tyre në komision.

Meqë nuk pati kuorum për vendimmarrje, kryesuesi procedoi me pikën e radhës të rendit të ditës.

16. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur nga 8 (tetë) deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës

Kryesuesi njoftoi se deputetja Shqipe Pantina, e mbështetur nga 8 (tetë) deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje", ka parashtruar kërkesë për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me punën dhe funksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 2016, ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar.

GP i LV-së, GP i AAK-së dhe GP "Nisma" i kanë propozuar deputetët për kryesues, zv. kryesues dhe anëtarë për këtë komision, ndërsa GP i PDK-së, GP i LDK-së, GP i LS-së dhe GP "6+" nuk i kanë bërë propozimet për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar të lartcekur.

Kryesuesi e hapi debatin lidhur me këtë çështje.

Lidhur me kërkesën e deputetes Shqipe Pantina për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës diskutuan Zenun Pajaziti, kryetar i GP të PDK-së dhe Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi tha se Kuvendi nuk ka kuorum për vendimmarrje. Ndërkohë, grupet parlamentare që nuk i kanë propozuar anëtarët për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës mund t'i propozojnë.

17. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se deputetja Margarita Kadriu-Ukelli, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Ai tha se Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të përgatisë një informatë para se të debatohet në Kuvend për çështjen e ngritur nga deputetja Margarita Kadriu-Ukelli. Deri tani Qeveria e Kosovës nuk ka dërguar në Kuvend informatë për këtë çështje.

Kryesuesi e ftoi deputeten Margarita Kadriu-Ukelli që në cilësinë e propozuesit të çështjes ta marrë fjalën.

Deputetja Margarita Kadriu-Ukelli, në fjalën e saj e arsyetoi urgjencën dhe rëndësinë e kërkesës për debat parlamentar lidhur me pretendimet e kompanive të ndryshme kontraktuese të Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera qeveritare në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Në fund, ajo theksoi se pas debatit parlamentar, Kuvendi duhet të nxjerrë rekomandime për Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Diskutimi i deputetes Margarita Kadriu-Ukelli është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin lidhur me pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, në emër të Qeverisë së Kosovës lidhur me çështjet e ngritura nga deputetja Kadriu-Ukelli tha se dy prej këtyre lëndëve vazhdojnë të jenë në arbitrazh ndërkombëtar, ndërsa njëra ka vendimin e arbitrazhit.

Po ashtu, lidhur me kërkesën e “AXOS”-it propozoi të mos hapet debat në Kuvend, ngase ekziston rreziku që pala e cila ka paditur Republikën e Kosovës mund të shfrytëzojë debatin e Kuvendit në procesin e arbitrazhit. Gjithashtu, edhe për kërkesat e tjera që kanë të bëjnë me Postë-Telekomin e Kosovës dhe me “DARDA Phone”-in, të cilat janë në shqyrtim e sipër, duhet të jemi të kujdesshëm në këto procese.

Diskutimi i plotë i kryeministrit është dhënë në transkript.

Për këtë pikë nuk pati diskutues të tjerë.

Në fund, kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum për vendimmarrje dhe i mbylli punimet e kësaj seance në orën 16:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale